

KËRKESË
Nr.2253, datë 14.4.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Mbështetur në ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë privat, që preket nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare publike, fshati Pezë-Helmës, “Ura e Beshirit” (komuna Ndroq), Tiranë ku subjekti kërkues i këtij objekti është komuna Ndroq, Tiranë.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm për procedurat e shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari që ka emrin në listën emërore bashkëlidhur dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës: adresa, rruga e Durrësit, nr.23 Tiranë.